



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:183845

Datë: 27.11.2023

Numri i dokumentit: 04975020

PPP.nr.72/2019

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA ISTOG, Departamenti i Pergjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (Kek) Sh.A, Rruga “Nëna Terezë”, numër 36, Prishtinë, ndaj debitorit M.H, nga fshati R., Komuna I, nga baza juridike përmbarimore pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër Urdhrit të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.371/19 i datës 26.06.2019, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24.11.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET I BAZUAR prapësimi i debitorit M.H nga fshati R. Komuna I, i parashtruar kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.371/19 i datës 26.06.2019.

II.SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbaruesit Privat Fatos Shatri në Pejë P.nr.371/19 i datës 26.06.2019.

A r s y e t i m

Kreditori Korporata Energjetike e Kosovës (Kek) Sh.A me seli në Prishtinë, me datë 26.06.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me energji elektrike për periudhën kohore nga data 27.02.2006 deri me datën 20.03.2013, baza juridike borxh në vlerë prej 1,952.99 €.

Përmbaruesi Privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit me Urdhrin P.nr.371/19 të datës 26.06.2019, ka lejuar përmbarimin e propozuar.

Debitori në afatin e lejuar ligjor, me datë 03.07.2019 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbarimor, duke u thirr në parashkrimin e borxhit.

Përfaqësuesi i kreditorit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilin ka propozuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi, duke shtuar se debitori me datën 01.09.2016, ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaratë mbi dakordimin e borxhit, ndërsa me datën 07.09.2016 ka bërë pagesën e këstit të parë, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve, mirëpo debitori ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ, nr 04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike dhe si i tillë për shkak të mospagesave të 8 kësteve, vlera e falur e borxhit i është rikthyer, ndërsa pagesat e bëra në emër të pagesës së energjisë me këste, i është minusuar në vlerën e përgjithshme të borxhit. Tutje ka shtuar se kërkesa për prapësim, nuk është në harmoni me nenin 69, paragrafin 4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e pales debitore, përgjigjen në prapësim të dhënë nga pala kreditore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka gjetur se prapësimi është në tërësi i bazuar.

Në propozimin për përmbarim të datës 26.06.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fatos Shatri me Urdhrin P.nr.371/19, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat afariste, nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 27.06.2006 deri me datën 20.03.2013.

Gjykata duke ju referuar thënieve në prapësim, si dhe shkresave tjetra të lëndës ka konstatuar se borxhi lëndor i kërkuar nga kreditori nga data 04.06.27.02.2006 deri me datën 20.03.2013 është i parashkruar dhe atë në shumë prej 1,952.99 €, për faktin se propozimi i kreditorit është parashtruar me datë 26.06.2019 për periudhën kohore 27.02.2016 deri me datën 20.03.2013 e duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 360 par. 1 pika 1.1 dhe par. 2 të LMD-së (Ligji Nr. 04/L-077) i cili përcakton: *se kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shëpiake, ndërsa afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”.*

Me dispozitën ligjore të nenin 71 të LPP-së është përcaktuar se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi, me çka në rastin konkret është plotësuar kushti i ligjor material-prapësimore i paraparë me këtë dispozitë për të vendosur si në pikën një të dispozitivit të këtij aktvendimi”.*

Lidhur me pretendimin e kreditorit si në përgjigje në prapësim, se debitori me datën 01.09.2016, ka nënshkruar kontratë për pagesën e borxhit, deklaratë mbi dakordimin e borxhit, ndërsa me datën 07.09.2016 ka bërë pagesën e këstit të parë, me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve,

gjykata konstatoi se kreditori propozimit për përmbarrim nuk i kishte bashkangjitur këto prova, përkatësisht kontratën për pagesën e borxhit si dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit, prandaj sipas vlerësimit të gjykatës, pavarësisht se në ekstraktin nga librat afariste, rrjedh se debitori ka bërë pagesë të energjisë elektrike me 10 këste në shumën nga 28.00 €, për periudhën nga data 07.09.2016 deri me datën 06.12.2018, por në shkresat e lëndës nuk ekzistonin provat, konkretisht, kontrata për pagesën e borxhit si dhe deklarata mbi dakordimin e borxhit të cilat argumentonin faktin që pagesa e kësteve ishte bërë sipas marrëveshjes, si dhe në sa këste ishte arrit marrëveshja që të bëhet pagesa e borxhit, pasi që sipas vlerësimit të gjykatës pagesa e këstit mund të bëhet vetëm nëse ka marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit për pagesën e borxhit në këste të caktuara dhe si rrjedhojë, gjykata erdhi në përfundim se borxhi i debitorit rezulton të jetë i parashkruar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të parashtruara nga palët, por ishin pa mdikim për vendosje ndryshe në këtë çështje.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.*

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.72/19, me datë 24.11.2023

Gj y q t a r j a
Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.